








3.1 SHIRITI I TITULLIT

Shiriti i titullit shtrihet në pjesën e sipërme të dritares. Në të ndodhet ikona e ndërfaqes për katalogimin e regjistrimeve bibliografike dhe titulli i dritares *Regjistrimi bibliografik*.

Madhësia e dritares së ndërfaqes për katalogim ndërrohet përmes butonave në shiritin e titullit (zvogëlohet , rritet  dhe rikthehet ). Dritaren mund ta zgjeroni mbi gjithë desktopin, nëse klikoni butonin  ose dy herë shiritin e titullit. Nëse klikoni butonin  ose dy herë në shiritin e titullit, dritaren e ktheni në madhësinë e parë, që zakonisht zë një pjesë të ekranit. Duke shtypur butonin  dritarja zvogëlohet deri në madhësinë e butonit në shiritin e detyrave. Megjithëse dritarja nuk shfaqet në desktop, është ende e hapur. Dritarja e zvogëluar hapet duke klikuar në butonin me emrin e saj në shiritin e detyrave.

Ndërfaqja për katalogim mbyllet duke shtypur butonin  në shiritin e titullit.